

URDHËR
Nr.216, datë 1.4.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.190, DATË 19.03.2020 “PËR
MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE PUBLIKE
DHE JOPUBLIKE DHE ÇERDHEVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË
INFEKSIONIT COVID-2019”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma “a”, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1, të urdhrit nr. 190, datë 19.3.2020 “Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-2019”, togfjalëshi “deri në datën 3.4.2020”, zëvendësohet me togfjalëshin “deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**
Ogerta Manastirliu